

FOLKLORISTIKA SHQIPTARE: QASJA, KONCEPTIMI, PERCEPTIMI ALBANIAN FOLKLORISTIC: APROACH, CONCEPTUALIZATION, PERCEPTION

ARBNOORA DUSHI

Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, KOSOVË
Email: arbnoradushi@hotmail.com

AKTET VI, 4: 370 - 374, 2013

PËRMBLEDHJE

Folkloristika shqiptare, ajo që ne e njohim, që është krijuar dhe vazhdon të zhvillohet në shkollat, universitetet dhe institutet shqiptare, brenda dhe jashtë kufijve të shtetit shqiptar, në gjendjen që është sot lë shumë për të dëshiruar. Ajo si e tillë, në kohën kur është krijuar ka luajtur një rol të madh në edukimin dhe vetëdijesimin si të nxënësve dhe të studentëve, ashtu edhe të shoqërisë, për vlerat e kulturës kombëtare. Mirëpo sot, kur hapat me të cilët zhvillohet shoqëria shqiptare janë shumë më të shpejtë, si edhe ndryshimet që pëson ajo janë shumë rapide, mendojmë se edhe folkloristika shqiptare si një fushë e përcjelljes së shpirtit krijues të njeriut shqiptar nuk është duke shkuar pas lëndës së saj. Dilemat në lidhje me këto çështje do të jenë pjesë e prezantimit të kësaj kumtese.

Fjalët çelës: folkloristika shqiptare, folklori, metodologjia, konceptimi, studime krahasimtare.

SUMMARY

Albanian Folkloristic, the one that we know, which was created and continues to develop in schools, universities and institutes, within and outside the borders of the Albanian state in the level that is today leaves much to be desired. It as such, when it was created has played a major role in the education and awareness of pupils and students, but also to society, for the values of the national culture. But today, when steps toward developing Albanian society are much faster as well as undergoing changes are more rapid, we think that Albanian Folkloristic as a field of tracking Albanian human creative spirit is not going after it. Dilemma regarding these issues will be part of the presentation of this paper.

Key words: Albanian folkloristic, folklore, methodology, conceptualization, comparative studies.

Hyrje

Folkloristika shqiptare, ajo që ne e njohim, që është krijuar dhe vazhdon të zhvillohet në shkollat, universitetet dhe institutet shqiptare, brenda dhe jashtë kufijve të shtetit shqiptar, në gjendjen që është sot lë shumë për të dëshiruar. Origjinën e këtij qëndrimi ndaj folklorit, unë së pari e shoh në shkollat tona publike, të cilat në programet shkollore të lëndës së letërsisë mësojnë për folklorin si një fushë shprehëse e njeriut që nuk di të shkruajë dhe të lexojë (apo nuk mësojnë se folklorin e krijojnë gjyshet kur tregojnë përrallat, ose rapsodët me lahutë e çifteli?) dhe jo më vonë, pasi që mendohet se me

të mësuar njeriu të shkruajë, krijon letërsi dhe më nuk krijon folklor.

1. Statusi i studimeve për folklorin

Në programet e letërsisë të shkollimit të lartë e superior për folklorin mësohet para se të mësohet për fazat e para të shkrimit dhe të teksteve letrare, pra edukimi dhe arsimimi për këtë fushë jepet në formën se folklori është krijim i masës kolektive që nuk ka një nivel shkollimi. Këtë qëndrim dëbues ndaj folklorit e ka ushqyer edhe përcjellja dhe vëzhgimi i vazhdueshëm që pushteti serb i ka bërë shqiptarëve (në Kosovë sigurisht), që janë marrë me mbledhjen dhe

regjistrimin e folklorit shqiptar, por edhe me tërë albanologjinë në përgjithësi, nga fillimet e deri në fund të shekullit XX. Marrjen me këtë disiplinë shkencore e kanë konsideruar si një veprimtari nacionaliste, ngaqë ata që kanë kontribuar në zhvillimin e vetëdijes së njerëzve për vlerat e kombit të vet, i kanë parë si armiq të politikës, gjoja, internacionaliste jugosllave. Kjo vetëdije i ka penguar atij pushteti dhe duke i përndjekur shqiptarët që e kanë vlerësuar këtë krijimtari, ka arritur “ta veshë” marrjen me folklorin me petkun e veprimtarisë nacionaliste, çka te shqiptarët ka krijuar lidhjen e folklorit me nacionalizmin. Ky qëndrim vazhdon të ketë jehonë edhe sot në shumë institucione tonat, të këtij shtetit tonë të ri, politika e të cilit e drejtuar nga ndërkombëtarët, synon ta shohë Kosovën si një shtet multi-etnik dhe, në vazhden e kësaj politike, të cilën e zbatojnë vetë shqiptarët, nuk investohet në folklorin pasi që ai shihet si një aktivitet nacionalist me ngarkesa mono-etnike, e cila nuk i duhet Kosovës multi-etnike.

Qëndrimin për folklorin si veprimtari e kulluar popullore, si edhe për folkloristikën si një shkencë që duhet të merret vetëm me folklorin e ashtuquajtur “të mirëfilltë”, duke u konsideruar i tillë vetëm folklori që e krijojnë rapsodët dhe që është i gjallë në zonat rurale, i ka kontribuar edhe qëndrimi i tejkaluar dhe i pazhvilluar i vetë folkloristëve dhe i shkencëtarëve të fushave të tjera shoqëror. Qëndrim ky që ka mbetur vendnumëro për shkak të pamundësisë së tyre që të jenë të hapur ndaj botës, që të jenë pjesë e shkollave dhe e studimeve ndërkombëtare dhe që të jenë në hap me rrjedhat e zhvillimit të folkloristikës evropiane e botërore në vazhdimësi. Kjo pamundësi është kushtëzuar nga izolimi i shqiptarëve në të dy anët e kufirit, për arsye herë politike, herë ekonomike, por që si rezultat ka dhënë izolimin dhe ngeljen prapa botës.

2. Koncepti modern për folklorin

Konceptet e këtilla për folklorin, si një krijimtari nacionaliste, si një shprehje e botës shpirtërore të njerëzve të paarsimuar, si edhe për folkloristikën si një shkencë që duhet marrë vetëm

me folklorin “e mirëfilltë”, nuk është se janë të panjohura për folkloristët perëndimorë, por ato, si të tilla, mjediset e zhvilluara akademike i kanë tejkaluar që në vitet ’50-’60 të shekullit XX, përderisa konsiderohen se vazhdojnë të mbrohen nga brezi i vjetër i folkloristëve të Evropës Lindore, por jo edhe nga të rinjtë e këtyre vendeve, të cilët me t’u hapur kufijtë ndaj Perëndimit i kanë përqafuar konceptet moderne për folklorin. Padyshim se edhe shkollat perëndimore i kanë pasur udhëkryqet e veta, ku janë vënë në sprovë ta mbrojnë folklorin “e mirëfilltë” bashkë me nacionalizmin dhe të mbesin aty ku ishin romantikët e shekujve XVIII-XIX, apo ta përparojnë folklorin duke i zgjeruar kufijtë e tij, ashtu që ai të pranohet si një fushë shprehëse e shoqërisë që ecën dhe që e krijon atë në vazhdimësi, pavarësisht lokalitetit ku zhvillohet, pavarësisht nivelit të arsimit që bart krijuesi.

Për rrjedhim koncepti që mbretëron sot për folklorin në shkollat dhe programet e përparuara, është se folklori është të mësuarit joformal që marrim në jetë, për botën tonë, për veten tonë, për shoqërinë tonë, për besimet tona, për kulturat dhe traditat tona, që e shprehim në mënyrë kreative nëpërmjet fjalëve, muzikës, zakoneve, veprimeve, sjelljeve dhe materialeve në një proces interaktiv dhe dinamik të krijimit, të komunikimit dhe të paraqitjes sonë (Sims & Stephens: 2005, (1-12)). Atë si të tillë e shpreh secili nga ne në të përditshmen tonë, duke dhënë dhe duke marrë me të tjerët, duke e shprehur botën e brendshme shpirtërore në një rrëfim të rastit me një mik a mikeshë, po ashtu siç edhe në një shfaqje zemërimi apo gëzimi, kur shprehim emocionet e përshtypjet tona nëpërmjet komunikimit verbal me të tjerët. Padyshim se edhe e bartim tek rrethi jonë, si edhe tek fëmijët tanë, ashtu siç edhe e kemi marrë nga paraardhësit tanë.

3. Folklori si mundësi / modele nga praktikat ndërkombëtare

Atëherë, kur i shohim këto modele të qasjes ndaj folklorit, paradigmën shqiptare dhe atë të shkollave perëndimore, e shohim se ajo që i

dallon nuk është se shqiptarët e kanë ende gjallë “folklorin e mirëfilltë” dhe nuk kanë nevojë ta kërkojnë atë tjetërkah në shoqëri, përderisa perëndimi atë “të mirëfilltin” e ka mbyllur në arkiva dhe tani e kërkon gjithkrah, por thelbi i dallimit është tek koncepti bazë për definicionin e folklorit. Koncepti shqiptar është shumë i ngushtë dhe i kufizuar. Nuk ka folklor të mirëfilltë dhe jo të mirëfilltë. Folklori është produkt shoqëror të cilin e krijon shoqëria, si ajo tradicionalja ashtu edhe ajo modernja. Është shprehja e botës së brendshme humane, nëpërmjet mjeteve joshkrimore, dhe ashtu siç e ka krijuar dhe vazhdon ta krijojë rapsodi p.sh. një këngë me tematikë historike ku i thurr lavdi heroit historik të një kohe, ashtu do ta krijojë edhe këngëtari i muzikës rap, i cili e shpreh përkushtimin për heroin e ditëve të tij.

Për t’i dhënë më shumë kuptim kësaj problematike do të shohim si trajtohet folklori dhe tradita në programet shkollore të kulturave bashkëkohore. Në botën e zhvilluar folklori dhe tradita gojore shihen më ndryshe dhe trajtohen më ndryshe, përderisa gjithkund këto tradita janë traditat që krijohen në popull dhe vendi e rëndësia që i jepet kësaj kulture në shkollat e shteteve të zhvilluara, apo më pak të zhvilluara, është shumë më e madhe se në shkollat tona.

Sot, në botë, për folklorin është konceptuar dhe pranuar definicioni se ai është art tradicional, letërsi, njohuri dhe praktikë që shpërndahet në masë të madhe nëpërmjet komunikimit gojor dhe shembujve të sjelljes. Me termin traditë gojore mbulohet tërë fusha e shprehjes gojore e cila ka lindur si pasojë e interaksioneve njerëzore dhe është e pranuar nga grupi (Dundes 1965: 3) që e ka krijuar, duke i dhënë statusin e krijimit tradicional, pra duke e transmetuar nëpër breza. Në kuptimin e përgjithshëm “tradita gojore” i referohet bartjes së kulturës materiale nëpërmjet mënyrës vokale të të shprehurit. Duke u pranuar si praktikë dhe proces që ka një shtrirje kaq të gjerë krijuese, në hapësirë dhe në kohë dhe që prodhon në vazhdimësi tradita gojore të popujve në botë, është shumë e kuptueshme dhe e arsyeshme që kjo krijimtari të ketë një vend të merituar në procesin e edukimit e të arsimimit të

brezave në institucione shkollore. Nëpërmjet transmetimit gojor të traditës barten edhe shembujt e sjelljes dhe krahas shumë funksioneve të tjera që ka ajo, shfaqet edhe funksioni edukativ. Dhe është mu ky funksion, i cili ia rrit vlerën dhe e rrit nevojën që tradita gojore të jetë pjesë e vazhdueshme e sistemit edukativ dhe arsimor. Konceptin për nevojën e domosdoshme të pranisë së lëndës gojore, përkatësisht folklorit, në programet shkollore, një studiues amerikan e shpreh në këtë mënyrë: “Të mësuarit për folklorin do të rezultojë me pasurimin e individualitetit të çdo nxënësi. Ai do të arrijë ta dojë dhe ta çmojë trashëgiminë e vet, e cila e dallon nga të tjerët që kanë parardhës të tjerë, histori ose të kaluar tjetër. Ai do të mësojë për shumë specifika kulturore, zakone, si dhe do të përfitojë aftësinë për të vërejtur pasuritë dhe diversitetet e sjelljeve njerëzore përreth tij. Dhe kjo do t’i krijojë atij ndjenjën dhe sigurinë që kurrë të mos ketë nevojë të ndihet i mërzitur nga ekzistenca e vet” (Davidson 1955: 188).

Qasja dhe trajtimi që i ofrohet traditës gojore në shumë shkolla perëndimore është mjaft pozitive. Kultura popullore dhe tradita gojore përbëjnë bazën e kulturës së cilitdo popull dhe ato pranohen si diçka shumë e çmuar dhe e paprekshme. E një vetëdije e tillë është rezultat i edukimit konstruktiv të bazuar në vlerat e kulturës kombëtare. Në vendet skandinave, në Finlandë, për shembull, nuk ekziston një finlandez i rritur, i shkolluar, i cili nuk do të dijë për eposin nacional, Kalevala, dhe për mbledhësit e tij, i cili nuk do të dijë për jetën dhe veprën e Elias Lonrotit, mbledhësit dhe kompiluesit të këngëve të Kalevalës që e ka fituar statusin e heroit kombëtar të kulturës finlandeze. Këtë dije për kulturën e tyre kombëtare finlandezët e mësojnë gjatë shkollimit fillor dhe të mesëm, se e ka bazën në dijen e kultivuar dhe jo për atë që e kanë mësuar nga traditat familjare.

Tradita gojore është pjesë shumë aktive e programeve shkollore në Indi, ku folklori është shumë i pasur dhe i larmishëm. Shumë shpesh rrëfimtari të profesionistë për një audiencë më të madhe nxënësisht rrëfejnë kallëzime nga tradita e vjetër indase e nga tekstet e vjetra në gjuhën

sanskrite, në të cilën janë krijuar *Ramajana* dhe *Mahabharata*. Në kulturën e Indisë, kultura gojore është e gjallë dhe aktive dhe është shumë e kërkuar për shijen e fëmijëve dhe të nxënësve (Agarwal 1992).

Gjithashtu, në shumë shtete, sidomos në SHBA, ku gjejmë një llojloshmëri traditash gojore e kulturash të ndryshme të popujve, programet shkollore me hapësirën jo të vogël që i japin folklorit bëhen shumë të pasura dhe shumë atraktive për nxënësit. Madje për mbrojtjen dhe ruajtjen e folklorit, si dhe për vetëdijesimin e njerëzve për vlerat e tij, mbahen konferenca ndërkombëtare, ku rekomandohen mënyra dhe metoda të pranueshme, në harmoni me nivelin e zhvillimit të popullatës në të gjitha moshat.

4. Trajtimi i zhanreve gojore në veçanti në programet shkollore ndërkombëtare dhe roli i tyre në formimin e personalitetit

Rëndësia që u kushtohet gjinive dhe zhanreve gojore në procesin e edukimit të brezave është shumë e çmueshme në shkollat ndërkombëtare. Prania e folklorit dhe e traditave gojore në kurrikulat dhe programet shkollore bëhet me qëllim të zhvillimit të personalitetit të fëmijës dhe të zbulimit të potencialeve të tij të brendshme.

Përralla si një zhanër fantastik-kreativ shumë shpesh e ndërlihdh realitetin me imagjinatën dhe nëpërmjet sfidave me të cilat ballafaqohet heroi i përrallës dhe luftës së tij ngadhënjyese, fëmijës i zhvillohet imagjinata, i shtohen vetëbesimi dhe nëpërmjet mësimave morale që dalin nga përralla atij i zhvillohet të gjykuarit. Përralla me motivin e futjes së djallit në shishe, ku nxjerrja e tij nga shishja kushtëzohet me plotësimin e tri dëshirave, e zhvillon fantazinë e nxënësit dhe siç thotë studiuesja Sandra Dolby, i shtyn ata të bëjnë pyetje, i shtyn t'i vënë vetes qëllime dhe të synojnë t'i arrijnë, si dhe i çon drejt kërkimeve të reja njohëse (Dolby 2005).

Format e tjera të prozës gojore si anekdotat e legjendat, apo edhe rrëfimet e tjera me elemente nga përvojat njerëzore dhe historia ia formojnë fëmijës dhe të riut, vetëdijen për trashëgiminë, për historinë, për traditën dhe ia konceptojnë

vetëdijen për identitetin e tij kulturor e kombëtar.

Këngët epike dhe baladat, ia ndërtojnë gjykimin për të vjetrën, të mundshmen e të pamundshmen, për historinë, për të vërtetën, për të njohurën e për të panjohurën. Këngët lirike ia zhvillojnë ndjenjën për të bukurën, butësinë e natyrën.

Kur jemi te përfshierja e traditës gojore në programet shkollore ndërkombëtare duhet të kemi parasysh se koncepti për traditën gojore si shprehje e kulturës së shoqërisë lëviz varësisht si lëviz shoqëria dhe dukuritë që e përcjellin atë. Ndaj edhe qasja nga traditës gojore është e ndryshueshme dhe e lëvizshme.

Tradita gojore nuk shihet vetëm si tekste të mbledhura nga krijuesit gojorë, krijimet e të cilëve i kanë rezistuar censurës së kohës, por tradita gojore sot shihet si një shfaqje krijuese, në të cilën rol aktiv kanë krijuesi dhe audienca e që janë në marrëdhënie interaktive. Kjo qasje i hap mundësitë e shumëkuptimit dhe të zbatimit të lëndës gojore në programet shkollore. Në Bullgari për shembull nxënësit e shkollave të mesme e kanë pjesë të programeve shkollore të dalin në terren dhe të mbledhin rrëfime gojore nga rrëfimtarët.

Rëndësia që shkollat dhe institucionet ndërkombëtare i japin traditës gojore në edukimin dhe arsimimin e fëmijëve në shkollat fillore e të mesme shihet nga hapësira që i jepet kësaj tradite në programet shkollore. Sidomos në shkollat e mesme, ku niveli mendor i zhvillimit të fëmijëve kërkon më shumë dhe ka kureshtje e vetëdije më të formuar për kulturën dhe traditën, materia e traditës gojore dhe e folklorit në tërësi është e pranishme në të gjitha nivelet e shkollimit të mesëm. Varësisht nga kulturat dhe traditat që kanë popujt, si dhe varësisht nga politika kombëtare për edukimin dhe arsimimin e brezave, lënda gojore autoktone bëhet pjesë e mësimave të tyre shkollore.

Përfundim

Nisur nga vendi shumë i pakët që i është lënë traditës gojore në programet e shkollimit të mesëm të shkollave tona: vetëm nëpërmjet programit të

lëndës së letërsisë dhe vetëm në pjesën e parë të tekstit për klasën e dhjetë (Hamiti; 2007), në një-rën anë dhe pasi që pamë disa nga praktikatat ndërkombëtare, ku folklori dhe tradita gojore janë pjesë përbërëse në vijimësi e programeve nëpër shkolla të mesme dhe nuk janë vetëm pjesë e programit të lëndës së letërsisë, në anën tjetër, vijmë te një përfundim: se për traditën shqiptare, atë gojore dhe materiale, nxënësit e shkollave tona të mesme duhet të mësojnë nëpërmjet një lënde të veçantë, ku do të kenë mundësi të njihen përveç me pjesën teorike për mësimin e kësaj lënde edhe me pjesën praktike të punës. Kjo nënkupton të aftësohen për identifikimin, mbledhjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

Nëpërmjet vizitave që do t'u bëjnë subjekteve (rrëfimtari, rapsodë, instrumentistë, etj.) në terren dhe nëpërmjet mundësisë që do t'u afrohet atyre për ta shprehur krijimtarinë e vet gojore, nxënësit do të njohin dhe do të arrijnë t'i duan dhe çmojnë vlerat që na karakterizojnë neve si popull.

Gjithashtu nëpërmjet mundësisë që fëmijët të kontaktojnë vetë me subjektet, të shohin muse-umet, të mbledhin rrëfimet e krijimet e tjera gojore duke filluar së pari nga familjarët e pastaj nga një rreth më i gjerë krijuesish do të arrijnë të aftësohen vetë për të dalluar vlerat nga jo vlerat

dhe do të arrijnë të vetëdijesohen për vlerat e popullit që e përfaqësojnë dhe kjo do të rezultojë me një përgatitje të qëndrueshme të personalitetit të nxënësit për t'u ballafaquar me sfidat që i dalin në jetë. Gjithashtu edhe me ndryshimin e koncepteve akademike për të, do të fillojmë ta shohim jo më si stigmë, por si një mundësi për ta njohur veten dhe botën rreth nesh.

Bibliografia:

- AGARWAL, Deepa, (1992), Role of Translating in Developing a National Children's Literature: Many Languages One Literature?, Preet Vihar, Delhi, India.
- DAVIDSON, Levette J. (1955), The Teaching of Folklore, Western Folklore, vol. 14. no. 3.
- DOLBY, Sandra K., (2005), Legends, High School History Classes, and the Scholarship of Teaching and Learning, published in Voices Vol. 31, Spring-Summer, New York Folklore Society.
- DUNDES, Alan (1965), What is folklore?, The study of folklore, Prentice hall.
- HAMITI, Sabri, (2007) Letërsia e vjetër shqiptare, për klasën e 10, ShB Albas, Tiranë, Tetovë, Prishtinë, ribotim.
- SIMS, Martha C. & Stephens, Martine, (2005), Living Folklore – an Introduction to the Study of People and Their Tradition, Utah University Press..